

UDHËZIM

Nr. 12, datë 14.7.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 30.5.2016, “PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT, MIRATIMIT, POROSITJES, SHPËRNDARJES DHE SHITJES SË TEKSTEVE SHKOLLORE DIGJITALE, NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR QË KANË LABORATORË ME TABLETA PËR INTEGRIMIN E PLATFORMËS *E-LEARNING*”

Në mbështetje të neneve 2 dhe 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të vendimit nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Fjalja e fundit e pikës 1, të kreut 1, të udhëzimit nr. 9, datë 30.5.2016, shfuqizohet.
2. Dy fjalitë e fundit të pikës 1, të kreut III, të udhëzimit nr. 9, datë 30.5.2016, shfuqizohen.
3. Pika 17/a, e kreut III, ndryshon si vijon:
 - a) Librin shkollor për lëndën përkatëse.
4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Komisioni i Vlerësimit të Teksteve Shkollore Digjitale në MAS, DAR/ZA, ISHA dhe institucionet shkollore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla